

VENDIM

Nr.108, datë 27.1.2009

PËR KRITERET E CILËSIMIT TË SHKELJEVE, ME PASOJA TË RËNDA, NË PYJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 38 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në varësi të dëmit mjedisor, që shkaktojnë, e të pasojave, që sjellin, në pyje, shkeljet, e parashikuara, shprehimisht, në pikën 1 të nenit 38 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, vlerësohen me pasoja të rënda, kur:

- a) janë kryer në një zonë pyjore të mbrojtur, sidomos në nënzonat e saj, që janë me status strikt të mbrojtur, duke i nxjerrë ato jashtë funksionit, për të cilin kanë marrë statusin e mbrojtjes;
- b) janë kryer në parcelat eksperimentale e studimore të pyjeve, të kullotave e të livadheve, duke bërë të pamundur vazhdimin e eksperimentimit e të studimit shkencor;
- c) kanë dëmtuar grumbujt e drurëve dhe të llojeve pyjore, të paracaktuara për konservim, germoplazmë, in situ dhe ex situ, për grumbullim, përpunim, shpërndarje dhe certifikim të materialit mbjellës;
- ç) janë kryer në një pyll mbrojtës, të cilësuar të tillë në planet e mbarështimit, duke e nxjerrë atë jashtë funksionit;
- d) kanë shkatërruar një monument pyjor natyror, të miratuar me një akt normativ;

dh) kanë asgjësuar, me prerje, me shkulje, me marrje, individë të llojeve të florës, të rralla, të rrezikuara e që gëzojnë status të veçantë mbrojtjeje;

e) ka shkatërruar cilësitë e një habitati konkret.

2. Shkeljet e tjera, të parashikuara, shprehimisht, në pikën 1 të nenit 38 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, kur nuk përbëjnë asnjërin nga rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, vlerësohen me pasoja të lehta.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e qeverisjes vendore për pyjet dhe kullotat komunale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha